

Java Botërore e Investitorëve 2018 - Edukimi dhe mbrojtja e investitorëve në krye të axhendës së IOSCO-s dhe AMF-së si anëtare e saj

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2018
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2018

Zhvillime të tjera

- AMF, marrëveshje bashkëpunimi me Institutin Kanadez të Teknologjisë për edukimin financiar dhe formimin e studentëve
- Paralajmërim mbi riskun e investimit në instrumentin “Kontratë për Diferencë” (CFD)
- Zhvillohet konferenca rajonale për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore
- Zhvillohet konferenca evropiane e instituteve kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve
- Zhvillohen mbledhjet e komiteteve të IOPS-it, si dhe Forumi Ndërkombëtar i IOPS/OECD mbi projektimin e sistemeve të pensioneve për t'u përballur me sfidat e plakjes

Edukimi i Konsumatorit

- Produkti i Pensionit Personal Pan-Evropian - Një hap drejt pensioneve të qëndrueshme (*pjesa e parë*)

Fjalor Termash

Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Maqedoni
- Poloni
- Rumani

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Java Botërore e Investitorëve 2018 - Edukimi dhe mbrojtja e investitorëve në krye të axhendës së IOSCO-s dhe AMF-së si anëtare e saj



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfshi në Javën Botërore të Investitorëve, përmes disa aktiviteteve të zhvilluara me përfaqësuesit e tregjeve, grupet e tjera të interesit, si edhe studentët.

Në datë 7 tetor 2018 anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) mbyllën javën e dytë botërore të investitorëve (WIW), por iniciativat e tyre për edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve do të vazhdojnë të shtrihen edhe përtej kësaj jave globale të ndërgjegjësimit.

Gjatë periudhës 1-7 tetor, rregullatorët e letrave me vlerë, bursat, organizatat ndërkombëtare, investitorët, shoqatat, entitetet arsimore dhe aktorë të tjerë, u bashkuan për të nxitur edukimin e investitorëve dhe mbrojtjen e tyre, që nga qendrat kryesore financiare në botë deri në skajet më të largëta të globit. Përgjatë kësaj jave, pjesëmarrës nga rreth 90 vende organizuan një sërë aktiviteteve të fokusuara tek investimet për të përcjellë rëndësinë e investimeve të mençura, veçanërisht në mjedisin e sotëm online dhe kohën dixhitale.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfshi në Javën Botërore të Investitorëve, përmes disa aktiviteteve të zhvilluara me përfaqësuesit e tregjeve, grupet e tjera të interesit, si edhe studentët.

Në zbatim të “Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”, AMF ka vijuar punën për rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me investimet në tregjet e kapitalit. Në këtë kuadër, janë zhvilluar sesione informuese me studentët, të cilët kanë vazhduar gjithashtu praktikatat e tyre mësimore pranë Autoritetit.

AMF ka vijuar trajnimet e edukimit në vazhdimësi me profesionistët e fushës, me qëllim rritjen e njohurive për tregjet e kapitalit, si edhe është përfshirë në një proces rishikimi të legjislacionit dhe rregulloreve për t'i përafuar me standardet më të mira ndërkombëtare. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar me të drejta të plota në IOSCO që prej vitit 1998.


VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-shtator 2018 kapën vlerën mbi 12,460 milionë lekë, ose 3.61% më shumë se në periudhën janar-shtator 2017. Gjatë periudhës janar-shtator 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 955,620 me një rritje prej 5.34% krahasuar me periudhën janar-shtator 2017.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.04% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.61% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.35%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.72% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.28% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shtator 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 955,620 me një rritje prej 5.34% krahasuar me periudhën janar-shtator 2017.




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2018

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2018 u dominua në masën 85.94% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 14.06% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 91.37% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2018 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 52.86% dhe 32.63% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.34% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë, janar-shtator 2018



Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2018 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 52.86% dhe 32.63% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-shtator 2018, ka pasur një rritje prej 264 milionë lekë ose 7.25% krahasuar me periudhën janar-shtator 2017. Ndërkohë edhe numri i transaksioneve është rritur në masën 11.89%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-shtator 2018, ka pasur ulje prej 254 milionë lekë ose 12.30% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 9.10%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 10 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-shtator 2017.

ZHVILLIME TË TJERA

AMF, marrëveshje bashkëpunimi me Institutin Kanadez të Teknologjisë për edukimin financiar dhe formimin e studentëve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 11 tetor 2018, një takim me përfaqësues të Institutit Kanadez të Teknologjisë (ICT), i cili u pasua nga nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Të pranishëm në takim ishin Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe përfaqësues të tjerë të Autoritetit, ndërsa ICT përfaqësohej nga rektori , Z. Gëzim Karapici dhe drejtues të tjerë.



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i ICT-së, Z. Gëzim Karapici, gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Z. Koçi deklaroi se Autoriteti është shumë i angazhuar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe rritjes së besimit në tregjet nën mbikëqyrje.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se bashkëpunimi me ICT bëhet në kuadër të zbatimit të strategjisë së nisur nga Autoriteti për edukimin financiar të publikut e në veçanti të studentëve, si edhe rritjes së aftësimin të tyre profesional. Z. Koçi deklaroi se Autoriteti është shumë i angazhuar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve dhe rritjes së besimit në tregjet nën mbikëqyrje.

Nga ana e tij, Z. Karapici theksoi se marrëveshja e bashkëpunimit pritet t'u shërbejë studentëve për të thelluar njohuritë e tyre për tregjet financiare nën mbikëqyrjen e Autoritetit, për përfitimin e praktikave mësimore dhe për t'u përgatitur sa më mirë për tregun e punës.

Në vitin e ri akademik, ekspertët e AMF-së dhe profesionistët nga fusha të ndryshme të tregjeve financiare jobankare do të zhvillojnë leksione të hapura në ICT, ndërsa në kuadër të marrëveshjes do të organizohen aktivitete të ndryshme ndërfaqësuese dhe edukuese për studentët.

Paralajmërim mbi riskun e investimit në instrumentin “Kontratë për Diferencë” (CFD)

Në kuadrin e mbrojtjes së investitorit dhe edukimit financiar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tërheq vëmendjen në lidhje me investimin në instrumentin “Kontratë për Diferencë” (CFD) për shkak të rrezikut që mbart ky lloj produkti.

Instrumentet financiarë CFD ofrohen kryesisht nëpërmjet platformave *online*. Për këtë arsye, shitja e tyre ka qenë në fokus të Rregullatorëve, veçanërisht të Autoritetit Evropian të Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA), i cili vazhdimisht ka paralajmëruar investitorët për rrezikshmërinë që paraqesin, si edhe ka vendosur disa kufizime në lidhje me marketingun shpërndarjen dhe shitjen e kontratave për diferencë, si dhe ndalimin e opsioneve binare. Bordi i Mbikëqyrësve të ESMA-s, në takimin e datës 26 shtator 2018, vendosi të rinovojë këto kufizime edhe për një afat tjetër 3 mujor.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare paralajmëron investitorët shqiptarë që përpara se të investojnë në këto lloj produktesh të kontrollojnë më parë nëse ofruesit e këtyre produkteve janë të autorizuar dhe licencuar për të ofruar këto shërbime nga rregullatorët e vendeve përkatëse.

Informacionin më të plotë e lexoni duke klikuar në linkun:
<http://amf.gov.al/kujdes.asp>

Zhvillohet konferenca rajonale për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkëpunim me aktorët ndërkombëtarë dhe publikë zhvilluan në datat 4-5 tetor, në Stamboll, Turqi Konferencën Rajonale “Financimi i Reduktimit të Riskut të Fatkeqësive”.

Qëllimi i konferencës ishte ngritja e një platforme shumëpalëshe për ndarjen e njohurive të financimit të fatkeqësive në rajon dhe organizimi i veprimeve të koordinuara për zhvillimin e financimit të fatkeqësive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare paralajmëron investitorët shqiptarë që përpara se të investojnë në këto lloj produktesh të kontrollojnë më parë nëse ofruesit e këtyre produkteve janë të autorizuar dhe licencuar për të ofruar këto shërbime nga rregullatorët e vendeve përkatëse.

Konferenca u fokusua në pyetjet që u ngritën për tri fusha kyçe:

- Cila është gjendja aktuale e financimit të fatkeqësive globale që kontribuon zhvillimin e qëndrueshëm në realitet? Çfarë mësimesh janë marrë dhe që mund të ndahen me vendet e rajonit?
- Si mund të ndihmojnë partnerët e zhvillimit ndërkombëtar, sektori privat dhe akademia që qeveritë të kapin potencialin e tregut global të financimit të fatkeqësive për ndërtimin qëndrueshëm të vendeve?
- Çfarë reformash politike nevojiten për të përshpejtuar zhvillimin e platformave kombëtare dhe rajonale të financimit të reduktimit të fatkeqësive dhe instrumenteve të tjera të financimit të Reduktimit të Riskut të Fatkeqësive (DRR)? Cilat kufizime politike, ekonomike, financiare dhe shoqërore duhet të adresohen?

Mbi transferimin e rrezikut, u trajtuan çështjet:

- Transferimi i rrezikut nga fatkeqësitë. Konsideratat kryesore për zhvillimin e financimit për zvogëlimin e riskut të katastrofave dhe programet e transferimit të tij;
- Nevoja për kapital për të rindërtuar asetet dhe për të shmangur ngjarjet, sa është e mundur, pas rimëkëmbjes;
- Pengesat specifike të rajonit: depërtimi i ulët, mungesa e zhvillimit të tregut të sigurimeve, proteksionizmi i sigurimeve;
- Tregjet e sigurimeve, mundësitë e sektorit privat dhe parashikimet ligjore, si dhe çështjet e menaxhimit të sigurimeve;
- Zhvillimi i produkteve që lidhen me sigurimet në tregjet e kapitaleve - Bonot e katastrofave, si mënyra më e mirë për qeveritë për të përballuar katastrofat;
- Çështjet ligjore me të cilat ballafaqohen qeveritë për transferimin e rrezikut të katastrofave;
- Krijimi i programeve shtetërore dhe lokale për përballimin e katastrofave;
- Risqet e katastrofave si mundësi investimi për investitorët.

Pjesëmarrësit pasqyruan projekte konkrete të zbatuara në zona të ndryshme, si dhe sfidat me të cilat përballeshin shtetet në politikat e tyre financiare për reduktimin e riskut të fatkeqësive dhe menaxhimin e tyre.

Zhvillohet konferenca evropiane e instituteve kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve

Qendra Kërkimore e Entiteteve të Sigurimeve dhe Fondeve të Pensionit (Investigación Cooperativa entre Entidades Aseguradoras y Fondos de Pensiones), me mbështetjen e Organizatës Evropiane të Instituteve Kombëtare për edukim në sigurime zhvilluan datat 17-20 tetor në Madrid, Spanjë, konferencën evropiane të instituteve kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve.

Qëllimi i kësaj konference ishte shkëmbimi i ideve dhe përvojave në çështjet e edukimit në tregun e sigurimeve.



Gjatë konferencës u diskutuan zhvillimet në teknologji në tregun e sigurimeve dhe mënyrat për t'i kaluar sfidat e së ardhmes dixhitale me fokus në edukimin financiar.

Institutet Kombëtare për edukim dhe formim profesional në tregun e sigurimeve të organizatave anëtare të Bashkimit Evropian pjesëmarrëse në këtë konferencë, përmes prezantimeve të tyre, ndanë zhvillimet e reja në tregjet vendase përsa i përket arsimimit dhe edukimit në tregun e sigurimeve dhe sfidat që u dalin përpara.

Gjatë konferencës u diskutuan zhvillimet në teknologji në tregun e sigurimeve dhe mënyrat për t'i kaluar sfidat e së ardhmes dixhitale me fokus në edukimin financiar. Disa nga çështjet e trajtuara ishin:

- Çfarë zhvillimesh dhe shanse shikoni në mësimin nëpërmjet teknologjisë dhe dixhitalizimit?
- Cilat teknologji do të përdoren në institucionin ku punoni gjatë dy viteve të fundit?
- Sa përqaset mësimi nëpërmjet teknologjisë nga brezi i ri?
- Cili do të jetë roli i instituteve/qendrave të trajnimit në të ardhmen, përsa i përket teknologjive të reja të trajnimit, etj.

Zhillohen mbledhjet e komiteteve të IOPS-it, si dhe Forumi Ndërkombëtar i IOPS/OECD mbi projektimin e sistemeve të pensioneve për t'u përballur me sfidat e plakjes

Forum global për pensionet private, 2018 u organizua në bashkëpunim të OECD, Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) dhe Komisionit Rregullator të Bankave dhe Sigurimeve të Kinës (CBIRC). Forumi mbledhi zyrtarë të nivelit të lartë nga autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, ekspertë nga industria e fondeve të pensioneve dhe institutet kërkimore nga vendet e OECD dhe IOPS. Pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga organizata ndërkombëtare.

Temat kryesore të trajtuara gjatë forumit ishin:

- Hartimi i sistemeve të pensioneve - si të përdoren komponentët publikë dhe privatë: reforma e pensioneve në Kinë dhe përvojat ndërkombëtare;
- Përshtatja e kuadrit rregullator për të inkurajuar inovacionin, për të zbutur rrezikun e sistemeve të pensionit nga jetëgjatësia;
- Fondi i pensioneve si një investim ESG (investimi i qëndrueshëm, investimi i përgjegjshëm shoqëror, investimi i lidhur me objektivat dhe misionin);
- Parashikimet e pensioneve: hartimi/komunikimi me anëtarët/mbikëqyrja.

Ky forum global i nivelit të lartë u mbajt paralelisht me takimet e Komitetit të IOPS-it dhe takimin e përgjithshëm vjetor të IOPS më 24-25 tetor 2018.



Produkti i Pensionit Personal Pan-Evropian - Një hap drejt pensioneve të qëndrueshme

Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) në fjalën e tij përshëndetëse në Konferencën Ndërkombëtare "Produkti i Pensionit Individual Pan-Evropian - Rregullorja, Efektet dhe Problemet" fletë për tre tematika kryesore:

(i) Përse na nevojitet një Produkt Pensioni Individual Pan-Evropian (PEPP)?

(ii) Cilat janë përfitimet nga PEPP-së?

(iii) Cili është roli i EIOPA-s në të ardhmen e PEPP-së?

Konferenca u organizua nga Universiteti i Financave, Biznesit dhe Sipërmarrësit (VUZF) në kuadër të Presidencës Bullgare të Këshillit të Bashkimit Evropian, 20 maj 2018.

(Pjesa e parë, me shkurtime dhe redaktime)

Kjo temë është kaq të rëndësishme dhe na përket të gjithëve, pensionet individuale. Konferenca e sotme do të paraqesë Produktin e Pensionit Personal Pan-Evropian.

Pse kemi nevojë për një PEPP?

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për faktin se Evropa përballet me një sfidë të madhe në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për pensionet e qytetarëve të saj.

Sistemet kombëtare të pensioneve po ndeshen me sfida që lidhen me ndryshimet demografike dhe ato të tregut të punës, si edhe nga presioni nga buxhetet kombëtare. Popullsia e Bashkimit Evropian po mplaket për shkak të kombinimit të dy faktorëve, rritjes së jetëgjatësisë dhe nivelit të ulët të lindjeve. Sistemet kombëtare të pensioneve mbështeten gjithnjë e më shumë në pensionet private suplementare. Megjithatë, sistemet tradicionale të pensioneve profesionale nuk janë të përgatitura për të mbështetur ndryshimin e mjedisit në tregun e punës dhe nuk mund të plotësojnë nevojën për të papunët, sipërmarrësit apo punëtorët në lëvizje.

Në mënyrë që të gjendet zgjidhja e duhur ndaj sfidave me të cilat përballet pensionet evropiane, duhet të merren në konsideratë pikat fillestare të shteteve anëtare evropiane. Në disa prej shteteve anëtare, tregu i produkteve të pensioneve individuale është pothuajse inekzistent. Vetëm 27% e evropianëve të moshës 25 dhe 59 janë të regjistruar në një produkt të pensionit individual me një objektiv pensioni afatgjatë. Kjo përfaqëson një potencial të madh për të zhvilluar një treg të pensioneve individuale evropiane, por njëkohësisht është një thirrje për zgjidhje praktike dhe ofrimin e mjeteve të përshtatshme për evropianët për pensionit e tyre.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm për faktin se Evropa përballet me një sfidë të madhe në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për pensionet e qytetarëve të saj.

Komisioni Evropian, bazuar në këshillat e EIOPA-s për zhvillimin e një tregu të vetëm të Bashkimit Evropian për produktet e pensioneve individuale, propozoi një rregullore për një produkt të pensionit individual Pan-Evropian, PEPP-ja që do të nxisë zhvillimin e një tregu evropian të madh dhe konkurrues për pensionet individuale.

Vitin e kaluar u bë një hap i guximshëm drejt zhblokimit të këtij potenciali. Komisioni Evropian, bazuar në këshillat e EIOPA-s për zhvillimin e një tregu të vetëm të Bashkimit Evropian për produktet e pensioneve individuale, propozoi një rregullore për një produkt të pensionit individual Pan-Evropian, PEPP-ja që do të nxisë zhvillimin e një tregu evropian të madh dhe konkurrues për pensionet individuale. Ky hap është një moment historik dhe një kusht i rëndësishëm për ecurinë e mëtejshme si të procesit të zhvillimit dhe zbatimit të PEPP.

Cilat janë përfitimet e PEPP-së?

Një treg më i zhvilluar për pensionet individuale në Bashkimin Evropian do të ndihmojë në arritjen e dy qëllimeve kryesore:

- Së pari, të sigurojë mundësi më të mira për një pension të përshtatshëm për qytetarët evropianë;
- Së dyti, të stimulojë më tepër kursime dhe ti kanalizojë ato në investime afatgjata, duke nxitur rritjen dhe duke kontribuar në objektivin e Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit.

Në një nivel mikroekonomik, PEPP-ja do të marrë kursimet e individëve që lidhen me pensionin e tyre dhe do tu ofrojë qytetarëve mundësi të hyjnë në një treg më të zgjeruar, si edhe me oferta më të mëdha në llojshmërinë e produkteve të reja.

PEPP është projektuar si një produkt afatgjatë, i kursimeve të sigurt, transparente dhe me kosto efektive që do t'i ofrojë pensionistëve mundësi të ardhurash pensioni, në kuadër të pensionit individual Evropian. Nëpërmjet PEPP-ve, kursimtarët do të kenë më shumë zgjedhje, nga një gamë e gjerë ofruesish, si edhe të drejtën për të ndryshuar ofruesit brenda dhe jashtë kufijve. PEPP-ja do të jetë e transferueshme midis shteteve të ndryshme anëtare. Kjo do të thotë që kursimtarët janë në gjendje të vazhdojnë të kontribuojnë me të njëjtën skemë pensioni edhe kur të kalojnë në një shtet tjetër anëtar. Brenda opsionit të parazgjedhur, kursimtarët do të përfitojnë nga një nivel i lartë i mbrojtjes së konsumatorit dhe kërkesa të vlefshme informacioni, duke përfshirë shpërndarjen online.

Gjithashtu PEPP-ja do të inkurajojë konkurrencën kur ofruesit të jenë në gjendje të ofrojnë produktet e tyre në disa shtete anëtare duke përdorur pasaportë të Bashkimit Evropian për të lehtësuar shpërndarjen ndërkufitare. Mundësitë e biznesit ndërkufitar, së bashku me një opsion standard të paracaktuar do të lejojnë arritjen e ekonomive të shkallës të rëndësishme për të arritur efikasitetin e koston, të ofrojë mundësi për produkte të reja si dhe hyrjen në treg të aktorëve e rinj.

Në mjedisin aktual ekonomik dhe sfidave me të cilat ballafaqohen produktet afatgjata, hartimi i opsionit të paracaktuar investimit do të përcaktojë një masë të konsiderueshme suksesin e PEPP.

Hartimi i kuadrit rregulluar i këtij produkti të pensioneve individuale, në veçanti nëpërmjet elementeve të standardizuara, mund të ndihmojë gjithashtu në rritjen e transparencës dhe kuptimit të konsumatorëve. Përveç kësaj, do të ofrojë një fushë të barabartë për ofruesit, do të rrisë besimin tek konsumatorët dhe do të sjellë ndryshimet në tregun evropian të punës. Në mjedisin aktual ekonomik dhe sfidave me të cilat ballafaqohen produktet afatgjata, hartimi i opsionit të paracaktuar investimit do të përcaktojë një masë të konsiderueshme suksesin e PEPP.

Për më tepër, është e rëndësishme lidhja konceptuale ndërmjet fazës së akumulimit të PEPP-së (faza së kursimit) dhe fazës së shpërndarjes (faza kur merren të ardhurat e pensionit).

Për të siguruar që PEPP-ja të jetë vërtet një produkt pensionesh si edhe për të siguruar mbrojtjen adekuate të përfitimeve nga kursimet nga strategjitë e suksesshme të investimeve afatgjata ndaj rrezikut të jetëgjatësisë, unë mendoj se opsioni i zgjedhur paraprakisht duhet të përfshijë kërkesat e mëposhtme:

- Nëse ofrohet, ai garantohet vetëm në pikën e shpërndarjes;
- Specifikimi i konvertimit të parazgjedhur të një pjese të konsiderueshme të shumës së akumuluar, në tërheqje të programuara ose anuitete.

Hartimi i PEPP-së duhet gjithashtu të sigurojë kushte për ti lejuar qytetarët e Bashkimit Evropian për të investuar në një portofol të balancuar duke përfshirë asetet si aksionet, pronat, infrastrukturën dhe teknologjitë e gjelbërta. Me masat e duhura mbrojtëse, kjo do të ofrojë një shans të mirë për të grumbulluar një pension që tejkalon inflacionin dhe rritet në nivele që mund të ofrojnë një standard të denjë jetese.

FJALOR TERMASH

ASK

Çmimi më i ulët që një shitës është i gatshëm të pranojë, kur shet një letër me vlerë/aksion (stock).

BEAR

Një investitor i cili beson se tregu në tërësi ose një aksion i veçantë do të bjerë. "Bear" është e kundërta e një "Bull".

BULL

Një investitor i cili beson se tregu në tërësi ose një aksion i veçantë do të rritet. Një "Bull" është e kundërta e një "Bear".

BULL MARKET

Kur shumica e çmimeve të aksioneve është në rritje përgjatë disa muajve.

BEAR MARKET

Kur shumica e çmimeve të aksioneve po bien disa muaj.

BID

Çmimi më i lartë që një blerës është i gatshëm të pranojë kur blen një letër me vlerë/aksion (stock).

BLUE CHIP

Një kompani që ka një histori të qëndrueshme të fitimit të të ardhurave të ngurta, dividente të rregullta dhe gjithnjë në rritje, dhe një bilanc të pastër.

BOOK VALUE

Vlera e një kompanie pasi janë hequr/zbritur të gjitha detyrimet nga totali i aktiveve.

BROKER

Një person që blen ose shet një investim/aksione/letra me vlerë për ju në këmbim të një tarife të quajtur komision.

DIVIDENDS

Një pjesë e fitimeve të një kompanie që paguhet aksionarëve në baza tremujore ose vjetore. Bordi i Drejtorëve të shoqërisë deklaron dividendë. Deklarimi i dividendëve nuk është i detyrueshëm, për stoqet e zakonshme, edhe pse kompania po realizon fitime të mira.

Bullgari

www.xprimm.com

Në gjysmën e parë të vitit 2018, tregu i sigurimeve në Bullgari ruajti ritmin e rritjes së një viti më parë prej 7.9%, me prime të shkruara bruto që kapën vlerën totale prej 627.5 milionë euro. Sigurimi i Jetës pësoi rënie me 5% dhe përbën 18.3% të primeve të shkruara bruto në treg. Në anën tjetër, sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 11.3%, me volumin e primeve të shkruara bruto në vlerën 512.7 milionë euro. Sigurimi motorik shënoi rritjen më të madhe, në masën 16.8%, duke mbetur në pozitë dominante në treg, në masën 60%. Sigurimi i pronës pësoi rënie, me 4.2%.

Maqedoni

www.xprimm.com

Siguruesit në Maqedoni e mbyllën gjysmën e parë të vitit 2018 me një volum primesh të shkruara bruto prej 80 milionë euro, me 6.7% rritje. Pjesa më e madhe e rritjes erdhi nga sigurimet e Jo-Jetës, në veçanti MTPL-ja dhe sigurimi i pronës. Sigurimi motorik shënoi rritje të ndjeshme, duke ruajtur pozitën dominuese në treg, pasuar nga sigurimi nga zjarri dhe dëme të tjera.

Poloni

www.xprimm.com

Tregu më i madh i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, Polonia, e mbylli 6-mujorin e parë të 2018 me prime të shkruara bruto prej 7.36 miliardë euro (32.12 miliardë zlotë). E shprehur në monedhën vendase, tregu u rrit me 1.7%, ndërsa për shkak të zhvlerësimit të zlotës ndaj euros, rezultoi një rënie e tregut me 1.4%. Sigurimet e Jetës pësuan rënie me 11.6%, duke arritur në 2.55 miliardë euro prime të shkruara bruto. Sigurimi i Jo-Jetës pësoi rritje me 5%, duke arritur në 4.8 miliardë euro prime të shkruara bruto. Sigurimi motorik u rrit, edhe pse jo me të njëjtin ritëm krahasuar me atë të vitit të kaluar. Edhe dëmet e paguara pësuan rritje, kryesisht në sigurimin e pronës për shkak të motit të keq.


Rumani

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Rumani e mbylli 6-mujorin e parë të vitit 2018 me 5.04 miliardë lei (RON, monedha lokale) ose 1.08 miliardë euro, pa ndryshime krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dëmet e paguara arritën në rreth 602.6 milionë euro. E shprehur në monedhën evropiane, primet e shkruara bruto rezultojnë me shifra negative rritjeje për shkak të zhvlerësimit të monedhës vendase me 2.4% ndaj euros. Për këtë arsye, në euro primet e shkruara bruto ranë me 2.3%. Sigurimi i Jetës u rrit me 0.34%, ndërsa sigurimi i Jo-Jetës ishte në të njëjtat nivele të një viti më parë. Në të dhënat e primeve të shkruara bruto nuk përfshihen ato të degëve të shoqërive të huaja të sigurimeve që operojnë në Rumani.


Në grafikët e mëposhtëm paraqiten të dhëna të përmbledhura mbi realizimin e primeve të shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit 2018, shprehur në euro, për vendet e rajonit dhe disa nga tregjet e Bashkimit Europian dhe Turqinë.

Volumi i primeve të shkruara bruto, 6-mujori i parë 2018, rajoni (Në mln. euro)



Burimi: www.xprimm.com

Volumi i primeve të shkruara bruto, 6-mujori i parë 2018, shtete të BE dhe Turqia (Në mln. euro)



Burimi: www.xprimm.com



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al